

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga shoqëria Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciegezellshaft me seli të regjistruar në adresën Porsheplac 1, 70435 Shtuttgart, Gjermani, dorëzuar përmes avokatit Bozhidar Millosheviq nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 04.07.2024, mori këtë

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciegezellshaft, me seli të regjistruar në adresën Porsheplac 1, 70435 Shtuttgart, Gjermani do të fitojë kontroll të pavarur mbi V4 Drajb Bateri GmbH (V4Drive Battery GmbH), me seli të regjistruar në Nurnberger Shtrase 64-65, 86720 Nurdlingen, Gjermani, përmes rritjes së kapitalit themelor, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2.Parashtruesi i njoftimit për përqendrim detyrohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6,000.00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 06.08.2024 në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua njoftim për përqendrim nga shoqëria Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciegezellshaft, me seli të regjistruar në adresën Porsheplac 1, 70435 Shtuttgart, Gjermani, me të cilin Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciegezellshaft do të fitojë kontroll të pavarur mbi V4 Drajb Bateri GmbH (V4Drive Battery GmbH), me seli të regjistruar në Nurnberger Shtrase 64-65, 86720 Nurdlingen, Gjermani, përmes rritjes së kapitalit themelor,

Para përqendrimit, V4 Drajb Bateri GmbH është në pronësi të plotë dhe nën kontrollin e pavarur të Varta AG me seli të regjistruar në VARTA-Plac 1, 73479 Ellvangen Jangst, Gjermani.

Përveç kësaj, para mbylljes së Transaksionit të Propozuar, Varta AG do të transferojë njësinë e biznesit për qelizat e mëdha të baterive litium-jon ("Biznesi i Baterive të Mëdha Litium-Jon"), e cila aktualisht operohet nga disa shoqëri të varura të Varta AG, tek V4 Drajb Bateri GmbH. Përveç serive të vogla të prodhimit të qelizave të rrumbullakëta litium-jon, kjo njësi biznesi

përbën biznesin e qelizave të rrumbullakëta litium-jon në format të madh për qëllime automobilistike (biznesi i e-mobilitetit) dhe qëllime jo-automobilistike (RoundPower). Njëkohësisht

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit me ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij konstatoi sa vijon:

Aktivitetet kryesore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

-Dr. Ing. h.c. F. Porshe Aktiegesellschaft është një prodhues gjerman i specializuar në zhvillimin, prodhimin dhe shitjen e makinave sportive me performancë të lartë, si dhe SUV dhe sedan. Selia e korporatës e Porshe ndodhet në Shtuttgart, Gjermani.

Dr. Ing. h.c. F. Porshe Aktiegesellschaft është njëshoqëri e varur nën kontrollin indirekt të Folksvagen Aktiegesellschaft (Volkswagen Aktiengesellschaft; „FVAG”), një kompani e listuar në bursë me seli në Wolfsburg, Gjermani, e cila është kompania kontrolluese e Grupit Folksvagen ("Grupi Folksvagen").

Grupi Folksvagen është aktiv në mbarë botën me zhvillimin, prodhimin, marketingun dhe shitjen e automjeteve për pasagjerë, automjeteve të lehta komerciale, kamionëve, autobusëve, autobusëve të transportit, shasisë së autobusëve dhe motorëve me naftë, motoçikletave, duke përfshirë pjesë rezervë dhe aksesori. Grupi Folksvagen gjithashtu merret me shpërndarjen e automjeteve. Grupi Folksvagen përfshin markat e automjeteve Folksvagen Pesinxher, Folksvagen Lajt Komrshal, Porshe, Audi, SHkoda, Lamborgini, SEAT, MAN, Skania dhe Dukati. Grupi Folksvagen ofron gjithashtu zgjidhje për shërbime të lëvizshmërisë, si automjete me kërkesë dhe ndarje automjetesh.

Përveç kësaj, Grupi Folksvagen ofron shërbime financiare dhe të sigurimeve të lidhura me shpërndarjen dhe financimin e automjeteve dhe automjeteve komerciale të tij. Kjo veprimtari kryhet kryesisht përmes Folksvagen Fajnenshl Servisis AG (Volkswagen Financial Services AG; "FSAG") dhe filialeve të saj. FSAG ofron shërbime si financim, lizing, sigurim dhe shërbime të prokurimit të sigurimeve në lidhje me automjetet dhe automjetet komerciale. Së fundi, përmes filialit të FSAG, Folksvagen Bank GmbH (Volkswagen Bank GmbH), Grupi Folksvagen ofron shërbime të drejtpërdrejta bankare.

Grupi Folksvagen është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërive të varura të mëposhtme:

-Porshe Lizing SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Bul. Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup dhe me veprimtari prioritare të regjistruar - Lizing financiar;

Porshe Broker SHA Shkup, me seli të regjistruar në Bul. Bosnnjë dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup dhe me veprimtari prioritare të regjistruar - aktivitete të agjentëve të sigurimeve dhe ndërmjetësve të sigurimeve;

Skania Macedonia SHPKNJP Ilinden, me seli të regjistruar në rr. 34 nr. 7 Ilinden, Shkup dhe me veprimtari prioritare të regjistruar - tregtia me automjete të tjera motorike dhe

Porshe Macedonia SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Bul. Bosnjë dhe Hercegovinë nr. 4 Shkup dhe me veprimtari prioritare të regjistruar - tregtia me automjete dhe automjete motorike të kategorisë së lehtë.

Objektivat e biznesit të V4Drajv Bateri GmbH janë kërkimi në produkte të ruajtjes së energjisë dhe prodhimi dhe shitja e produkteve të ruajtjes së energjisë.

V4Drajv Bateri GmbH nuk është i pranishëm dhe nuk gjeneron të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi që i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit dhe pikën 6 c) i) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi që nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска